



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:039033
Datë: 17.09.2018
Numri i dokumentit: 00123367

P.nr. 428/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. H. nga fsh: Gj. Komua e Suharekës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.1056-3/2017 të dt:02.06.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt 17.09.2018, në prezenc të PSH Atnor Skoro, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. H. nga i ati A. , e ëma Gj., e lindur G. ,i lindur me dt. 15.05.1971, në fsh Gj. Komua e Suharekës , i martuar ,baba i katër fëmijve,ka të kryer shkollën fillore ,i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 28.03.2017,rreth orës 15:15 minuta ,në rrugën magjistrale S.-P. nga pakujdesia rrezikon trafikun publik,jetën e njerzvedhe pasurinë,si pjesmarrs në komunikacionin rrugorëduke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës”A. RU2” ,me targa të regjistrimit 04-...-EQ,vepron në kundërshtim me rregullat e komunikacionit,në atë menyrë që derisa ishte duke e drejtuar automjetine e ti në rrugën S.-P.,dhe me të arritur në hyrje të fshatit T.,gjegjësisht në kryqëzimin me rrugë që shpije në fshatin L.,nuk mban distancën e mjaftushme të sigurisë ndaj automjetit i cili lëvizte para tij,dhe me pjesën frontale të automjetit ,e godet në pjesën e pasme automjetin e markës”M.”të cilin e drejtonte D. M.,ku pos dëmeve matriale në automjet ,lendime të lehta trupore pëson i dëmtuari D. M.,dhe atë:përdredhje në qafë dhe shpinë.

Me këtë ka kryer veprën penale , rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1,të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43,46,73,74 si dhe nenit 378 par 6 lidhur me par. 1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

DENIMIN ME GJOBË

Të akuzuarin M. H. ia shqipton denimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind Euro)**, të cilin denim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi. Në rast se denimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, konform nenit 46 paragrafi 3 te KPP, denimi me gjobë shëndrrohet me denim me burg në kohëzgjatje prej **10 ditësh**, duke llogaritur për çdo 20 €, një ditë burg.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 € në emër të ekspertit të komunikacionit shumë prej 40.88 € dhe ne emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 € dhe në emër të takses për kompenzime e viktimave të krimit shumë prej 30 €.

I dëmtuari D. M. për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën, PP.II.nr.1056-3/2017 të dt:02.06.2017 akuzuar M. H. nga n fsh: Gj. Komua e Suharekës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KP aktakuzën të cilin gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjerë në mbarimin e tij e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro , i cili në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 17.09.2018. dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:
Me datë 28.03.2017, rreth orës 15:15 minuta ,në rrugën magjistrale S.-P. nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerzvedhe pasurinë, si pjesmarr në komunikacionin rrugorëd uke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës”A. RU 2 “, me targa të regjistrimit 04-...-EQ, vepron në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, në atë menyrë që derisa ishte duke e drejtuar automjetin e ti në rrugën S.-P., dhe me të arritur në hyrje të fshatit T., gjeqjesisht në kryqëzimin me rrugë që shpije në fshatin L., nuk mban distancën e mjaftushme të sigurisë ndaj automjetit i cili lëvizte para tij, dhe me pjesën frontale të automjetit , e godet në pjesën e pasme automjetin e markës”M.” të cilin e drejtonte D. M., ku pos dëmeve materiale në automjet , lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari Daut Muharremaj, dhe atë: përdredhje në qafë dhe shpinë.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit icili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza siq janë: Njesia e Trafikut Regjional ne Prizeren , me nr 2017-GR-0177, të dt:28.03.2017, mendimi i ekspertit mjeko ligjor Dr. M. G. të dt. 14.05.2017, Mendimi dhe konstatimin e ekspertizës të ekspertit të komunikacionit ing.B. K. të dt: 26.05.2017 nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale rrezikimi i trifikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi denimin siq është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tersi të veprës se kryer, është hera e parë që ndeshet me ligjin, ndërsa posaqerisht rrethanë rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË.
P.nr.428/2017të dt.17.09.2018

Sek. Juridike
Fitnete. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.